

S T A T U T I

I

UNIVERSITETIT ISMAIL QEMALI TE VLORES

Permbajtja

Kreu 1 : Dispozita te pergjithshme

- Neni 1 : Pozita juridike
- Neni 2 : Pozita juridike
- Neni 3 : Roli dhe Misioni
- Neni 4 : Qëllimet
- Neni 5 : Parimet organizative
- Neni 6 : Programimi i veprimtarisë

Kreu 2 : Organet drejtuese ne Universitetet

- Neni 7 : Senati akademik
- Neni 8 : Keshilli i administrimit
- Neni 9 : Keshilli i etikes
- Neni 10 : Rektori
- Neni 11 : Zevendes-rektoret
- Neni 12 : Kancelari

Kreu 3 : Organizimi

- Neni 13 : Njesite perberese
- Neni 14 : Rektorati
- Neni 15 : Fakultetet
- Neni 16 : Departamentet

Kreu 4 : Organizimi i studimeve

- Neni 17 : Pranimet për studimet universitare
- Neni 18 : Ciklet dhe titujt e studimeve universitare
- Neni 19 : Pranimi në ciklin e parë të studimeve
- Neni 20 : Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies
- Neni 21 : Transferimet
- Neni 22 : Pajisja me diplomë
- Neni 23 : Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve
- Neni 24 : Viti akademik sabatik
- Neni 25 : Vleresimi i studenteve
- Neni 26 : Detyrimet e të Drejtat e Studentëve

Kreu 5 : Struktura, organika dhe punesimi

- Neni 27 : Struktura dhe Organika
- Neni 28 : Personeli
- Neni 29 : Punësimi i personelit me kohë të plotë
- Neni 30 : Kerkesat për Punësim
- Neni 31 : Norma mesimore dhe mbingarkesa
- Neni 32 : Procedura e Konkurimit

- Neni 33 : Komisioni i vleresimit te marrjes ne pune
- Neni 34 : Koha e Provës
- Neni 35 : Kontratat e Punës
- Neni 36 : Personeli Akademik i Ftuar
- Neni 37 : Personeli Akademik me Kontratë
- Neni 38 : Mbarimi i Marrëdhënies së Punës
- Neni 39 : Masat Disiplinore
- Neni 40 : Kerkimi shkencor

KREU I : DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Pozita juridike

Neni 1

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlore eshte institucion publik i Arsimit te Lartë, me karakter mesimor e shkencor. Ai eshte krijuar me vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 105, dt. 28.02.1994, bazuar ne nenin 57, pika 7 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise".
2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlore eshte person juridik me seli ne godinen qendrore te Rektoratit, me vendodhje ne Lagjen "Pavarsia", Rruga "Skele" Vlore, Albania.
3. Rektori eshte autoriteti qe vepron ne emër te Universitetit "Ismail Qemali" Vlore, brenda kufijve te drejtave qe i njeh Ligji i Arsimit te Larte Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 9832, datë 12.11.2007 Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar, ky Statut, Rregullorja e dhe akte te tjera ligjore e nënligjore.
4. Stema dhe vula e Universitetit "Ismail Qemali" Vlore eshte sipas anekseve bashkëlidhur këtij statuti.

Neni 2

Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlore është hartuar, bazuar në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 9832, datë 12.11.2007 Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në gjithë legjisllacionin tjetër në fuqi. Ai e shtrin veprimin e vet mbi të gjitha njësitë përbërëse organizative të këtij Universiteti.

Neni 3 :

Roli dhe Misioni: Përcaktimi i mëposhtëm i rolit dhe misionit të universitetit është si me poshte. Në të theksohen katër përbërësit thelbësorë për drejtimin e universitetit:

- mësimdhënie bashkekohore sipas te gjitha standarteve nderkombetare;
- punë kërkimore bazë dhe e aplikuar, si dhe punë akademike të cilësisë së lartë;
- shërbime të efektshme dhe ndikuese në publik dhe në komunitet;
- programe gjithëpërfshirëse aktivitetesh për zhvillimin e studentëve.

Si institucion i arsimit të lartë i mbështetur nga shteti, Universiteti i Vlorës ka një mision të dyfishtë:

- Ai ofron programe mësimore të cilësisë më të lartë që kulminojnë në diplomat e nivelit universitar, të nivelit master dhe doktoratura, si edhe programe të tjera kualifikimesh profesionale;
- Ai e con përpara njohurinë dhe shkencën përmes punës kërkimore, punës akademike dhe aktivitetit kreativ.

Në të gjitha aktivitetet e tij, Universiteti synon të jetë shembull drejtimi në arsim.

Neni 4

Qëllimet

1. Universiteti Ismail Qemali i Vlores, është një bashkësi që ka për detyrë parësore kërkimin, studimin dhe formimin e shkencor të studenteve të Universitetit Ismail Qemali të Vlores.
2. Universiteti Ismail Qemali i Vlores ushtron funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës, për çdo tip formimi të nivelit të lartë, përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë apo plotësuese për to, si dhe kërkimin e aplikuar për problemet, me interes publik apo privat.
3. Universiteti Ismail Qemali i Vlores ndërmerr çdo inisiativë derisa e drejta e studimit të thelluar të studentit të jetë përmbushur në tre nivelet, si dhe u garanton atyre realizimin e objektivat kulturore dhe profesionale.
4. Universiteti Ismail Qemali i Vlores u garanton punonjësve akademikë mundësi të barabarta për të përfituar nga financimet për kërkimin shkencor.
5. Universiteti Ismail Qemali i Vlores promovon dhe nxit dimensionin ndërkombëtar të studimeve, të të mësuarit dhe të kërkimit shkencor. Universiteti Ismail Qemali i Vlores konsideron si një nga detyrat e tij themelore edhe zhvillimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të pedagogëve dhe të studentëve, si dhe pranimin e formimin e studentëve të huaj.
6. Universiteti Ismail Qemali i Vlores ndjek qëllimet e tij në përputhje të plotë me dinjitetin human, në pluralizmin e ideve dhe në transparencën e procedurave. I garanton çdo pedagogu autonominë e kërkimit dhe lirinë e mësimdhënies, sipas dispozitave të këtij Statuti, në përputhje me legjisllacionin në fuqi, me të drejtën e studimit dhe pozitën juridike përkatëse.
7. Universiteti Ismail Qemali i Vlores lëshon diploma, çertifikata apo tituj të tjerë në përputhje me nivelin e formimit të kryer. Gjithashtu lëshon tituj perfeksionimi për master në fusha të caktuara, si dhe për kurse formimi universitar bazë apo kurse ad hoc, sipas nevojave të shoqërisë.

8. Universiteti Ismail Qemali i Vlores promovon aktivitete shkencore, organizon dhe përmbush shërbime kulturore dhe formuese në territorin e qarkut të Vlores, në të gjithë vendin, si dhe jashtë tij.
9. Universiteti Ismail Qemali i Vlores organizon brenda tij vlerësimin e arritjes së qëllimeve të tij institucionale.
10. Universiteti Ismail Qemali i Vlores vendos dhe favorizon drejtimin didaktik të studentëve sipas nevojave formuese të tyre.
11. Universiteti Ismail Qemali i Vlores është institucion i depolitizuar dhe laik dhe respekton shprehjen e lirë të ideve sipas Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

Neni 5

Parimet organizative

1. Universiteti Ismail Qemali i Vlores ka zotësi të plotë për të vepruar si subjekt i së drejtës publike dhe private, për të përmbushur qëllimet e tij, si dhe në ushtrim të kompetencave përkatëse, me përjashtim të atyre që nuk sjellin asnjë përfitim për qëllimet e universitetit.
2. Universiteti Ismail Qemali i Vlores favorizon e garanton, diskutimin dhe shkëmbimin e mendimit të lirë për problemet që lidhen me përmbushjen e qëllimeve të universitetit. Gjithashtu garanton publikimin e propozimeve të akteve që shqyrtojnë organet e tij, me përjashtim të atyre propozimeve që kanë karakter thelbësisht privat apo personal. Publikimi kryhet me anë të shpalljes apo shpërndarjes së projektakteve, si dhe me njoftimin e mëpastajëm të akteve të miratuara nga organet kolegjiale përkatëse.
3. Universiteti Ismail Qemali i Vlores favorizon pjesmarrjen në votime dhe fshehtësinë e votës, në zgjedhjen e organeve të tij.
4. Universiteti Ismail Qemali i Vlores vlerëson mënyrën e përdorimit të buxhetit të shpenzuar nga njësitë e tij në përmbushjen e detyrave përkatëse, me qëllim ekonomizimin dhe efikasitetin e drejtimit të Universitetit dhe përpunon e shpall indikatorët për të verifikuar objektivat e vendosura, rezultatet e arritura dhe kostot përkatëse.
5. Bilancet e Universitetit dhe të njëjësive të tij, që kanë autonomi të brendshme financiare bëhen publike 30 ditë pas aprovimit nga organi përkatës.
6. Universiteti vendos lirisht për të kërkuar konsulencën e Avokaturës së Shtetit apo të avokatëve, profesionistë të lirë, të rregjistruar në Dhomën Kombëtare të Avokatëve.

Neni 6

Programimi i veprimtarisë

1. Universiteti Ismail Qemali i Vlores e zhvillon veprimtarinë e tij institucionale ne menyre te pavarur ne sistemin universitar nderkombetar, me partnere me të cilët bashkëpunon dhe vetërregullon marrëdhëniet me qëllim përmbushjen e objektivave të tij.
2. Universiteti Ismail Qemali i Vlores në përputhje me objektivat e tij, të politikës kulturore, të kërkimit, të mësimdhënies dhe në respektimin e lirisë të secilit, harton programe dhe projekte specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkurren me këto projekte në planin kombëtar për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor, si dhe në planin ndërkombëtar.

KREU II: ORGANET DREJTUESE NE UNIVERSITET

Neni 7

Senati akademik

1. Senati akademik, përveç kompetencave të parashikuara në nenin 14, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", ushtron edhe këto kompetenca:
 - a) Përcakton drejtimin akademik të Universitetit dhe strategjine afatgjate të zhvillimit.
 - b) Vendos hapjen apo mbylljen e degëve të reja në Universitet
 - c) Vendos kuotat e pranimeve në Universitet, si dhe tarifat e rregjistrimit dhe të studimeve;
 - d) Përcakton kritere të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar student në ciklin e parë, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve;
 - e) Përcakton kriteret e pranimi për kandidatë në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve, si dhe kuotat përkatëse ia propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës;
 - f) Miraton marrëveshjet apo kontratat e bashkëpunimit me të tretë, që do të nënshkruajë Rektori, në emër dhe për llogari të Universitetit;
 - g) Miraton paraprakisht rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
 - h) Shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, vendimet e këshillit të fakultetit, kur bien ndesh strategjine e Universitetit.
 - i) Miraton krijimin e qendrave apo kurseve të posacme, si dhe projekte të tjera shërbimi që ofrohen nga fakultetet, bazuar në propozimin e këshillit të fakultetit përkatës.
 - j) Miraton kriteret për përzgjedhjen e pedagogëve të rinj efektive dhe të jashtëm.
 - k) Miraton formatin e kontratave për pedagogët efektive dhe të jashtëm.
2. Mandati i anëtarit të Senatit akademik mbaron kur:
 - a) përmbushet afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) largohet nga Universiteti i Vlores ;
 - d) vdes, bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin;
 - e) kur nuk merr pjesë, për 3 herë rradhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit akademik;
 - f) kur shkel etiken profesionale ose demton imazhin publik të Universitetit.
3. Vendi i mbetur vakant plotësohet me një nga punonjësit mësimorë, i emëruar nga këshilli i fakultetit, nga i njëjti fakultet, që përfaqëson anëtarin pararendës.

4. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Senatit akademik, rendi i ditës, votimi dhe çështje të tjera të lidhura me to parashikohen në rregulloren e Universitetit.

Neni 8

Këshilli i administrimit

1. Këshilli i administrimit, përveç kompetencave që parashikohen në nenin 16, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", ushtron edhe këto kompetenca:

- a) Cdo njesi kryesore do te perfaqsohet ne KA me nga dy anetare;
- b) miraton paraprakisht tarifën e rregjistrimit dhe të studimeve në Universitet dhe ia përcjell për miratim të mëtejshëm Senatit Akademik;
- c) informon Senatin Akademik dhe Rektorin për situatën financiare dhe projektet përkatëse për të gjithë Universitetin;

2. Mandati i anëtarit të Këshillit të administrimit mbaron kur:

- a) përmbushet afati i mandatit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) largohet nga Universiteti i Vlores , për ata që janë të caktuar sipas pikës 4, shkronjat "a" dhe "c", të nenit 16, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë";
- d) vdes, bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrrojë funksionin;
- e) kur nuk merr pjesë, për 3 herë rradhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjet e këshillit të administrimit;
- f) për ata që janë të emëruar sipas pikës 5, të nenit 16, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", kur lirohen me akt të Ministrit dhe në këtë rast Ministri detyrohet të njoftojë Rektorin 15 ditë përpara se emërimi i ri të hyjë në fuqi.

3. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Këshillit të Administrimit, rendi i ditës, pjesmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e Universitetit dhe në rregulloren e brendshme të Këshillit të Administrimit.

Neni 9

Këshilli i etikës

1. Anëtarët e këshillit të etikës perzgjidhen nga Senati akademik, sipas propozimeve të Rektorit. Këshilli i etikës përbëhet nga 7 anëtarë te cilet zgjedhin kryetarin me votim te fshehte.
2. Këshilli i etikës i propozon Senatit kodin e etikës së universitetit.

3. Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në rregulloren e Universitetit.
4. Këshilli i etikes ka te drejte t'i propozojë Rektorit masa konkrete mbi punonjesit e Universitetit të cilët thyejnë normat e etikes që pasqyrohen në kodin e etikes.

Neni 10

Rektori

1. Rektori, përveç kompetencave që ushtron si drejtues i Rektoratit, siç përcaktohet në nenin 15, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", ushtron edhe këto kompetenca:
 - a) paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë për t'u shqyrtuar nga Senati akademik, këshilli i administrimit apo këshilli i etikës;
 - b) i kërkon raportim këshillit të administrimit për çështje të kompetencës së këtij organi;
 - c) shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, aktet e dekanit, kur bien ndesh me interesat e universitetit, Kushtetutën apo me legjislacionin në fuqi;
 - d) propozon strukturën dhe numrin e të punësuarëve në Universitet;
 - e) nëshkruan kontratat e punës për të punësuarit në Universitet;
 - f) nëshkruan diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, pa të drejtë për ta deleguar nënshkrimin;
 - g) ngre komisione e grupe pune për çështje, studime e veprimtari të veçanta.
2. Mandati i Rektorit mbaron kur:
 - a) përfundon afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) vdes, bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrorë funksionin;
 - d) në rastin e parashikuar në pikën 3, të nenit 64, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë";
3. Marrëdhëniet e Rektorit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në rregulloren e Universitetit.

Neni 11

Zëvendësrektoret

Kriteret për tu emeruar zëvendës-rektor:

1. Zevendes-rektori perzgjidhet nga rektori me miratimin e Senatit
2. Preferenca eshte te perzgjidhet individi me titull dhe grade sa me te larte. Minimumi eshte te kete graden doktor shkencash.

Detyrat

1. Zëvendësrektori kryen detyrat e përcaktuara në statut dhe rregullore, si edhe të gjitha kompetencat e deleguara nga Rektorit;
3. Në rastin kur ka më shumë se një zëvendësrektor fusha e kompetencës e secilit përcaktohet në statut dhe rregullore;
2. Marrëdhëniet e zëvendësrektorit me organet e tjera në Rektorat dhe në të gjithë Universitetin përcaktohen në rregulloren e Universitetit;
3. Percjell urdherat e Rektorit tek dekanet dhe kontrollon ecurine e punes ne njesite kryesore.

Neni 12

Kancelari

Kancelari i Universitetit përgatit propozimet për në Këshillin e Administrimit, mban procesverbalin dhe përpilon vendimet e miratuara. Vendimet janë të vlefshme kur nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit të Administrimit dhe Kancelari i Universitetit.

Përshkrimi i detyrave të kancelarit përcaktohet në Rregulloren e Institucionit.

1. Kancelari ushtron këto kompetenca:
 - a) përgjigjet për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Universitetit, me përjashtim të kompetencave ekskluzive të Këshillit të Administrimit;
 - b) është titullar i entit prokurues;
 - c) i paraqet aktet me natyrë ekonomike dhe financiare për miratim në Këshillin e Administrimit dhe për mendim paraprak në Senatin akademik, kur është e nevojshme;
 - d) propozon studimet për zhvillimin perspektiv të Universitetit;
 - e) propozon strukturat dhe numrin e personelit për Rektoratin dhe fakultet, pasi ka marrë propozimet e këshillave të tyre;
 - f) organizon kryerjen e kontroll-revizionit financiar të Universitetit;
 - g) përfaqëson Universitetin e Vlores si firmë e parë e deleguar nga Rektori në marrëdhënie financiare me Bankën e Shtetit Shqiptar dhe në marrëdhëniet kontraktore me të tretët, brenda përshkrimit të tij të punës;

2. Marrëdhëniet e kancelarit me organet e tjera në Rektorat dhe të Universitetit, si dhe detyra të tjera që mund t'i delegohen përcaktohen në rregulloren e Universitetit.

KREU III: ORGANIZIMI

Neni 13

Njësitë përbërëse

1. Universiteti i Vlores ka këto njësi përbërëse:

- Rektoratin,
- Fakultetin e Ekonomise dhe Drejtësisë,
- Fakultetin e Shkencave Teknike,
- Fakultetin e Edukimit,
- Departamentin e Infermierisë

3. Secila nga këto njësi ka strukturën e saj, si dhe ka autonomi normuese, vetveprimi dhe financiare, sipas përcaktimeve në këtë Statut dhe në rregulloren e Universitetit.

4. Strukturat e reja të Universitetit krijohen vetëm me vendim të Senatit Akademik. Ndryshimi i këtyre strukturave duhet të pasqyrohet menjëherë në statut.

Neni 14

Rektorati

Rektorati përbehet nga

- Rektori
- Zevendes-rektoret
- Dekanet
- Kancelari

Në varesi direkte të Rektorit është administrata e universitetit e cila përbehet nga

- Zyra e regjistrimit
- Zyra e kërkimit shkencor
- Zyra e burimeve njerezore
- Zyra akademike
- Zyra e studenteve.
- Zyra e asistencës juridike
- Zyra e marrëdhënieve me publikun
- Dega ekonomike

2. Rektorati, përveç misionit, të drejtave dhe detyrave, që përcaktohen në nenin 15, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ushtron edhe këto kompetenca:

- a. Ofron infrastrukturën dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen e funksionimit të organeve drejtuese të Universitetit;
 - b. Ushtron kontrolle tematike, të organizuara apo spontane në njësitë e Universitetit për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të Universitetit.
3. Në varesi nga struktura dhe numri i personelit të Rektoratit, të miratuar nga Këshilli i Administrimit, miratohet dhe rregullorja e punës së Rektoratit, në të cilën përfshihen përshkrimet e punës të secilit punonjës, me përjashtim të atyre punonjësve që i kanë të përcaktuara në akte të tjera. Struktura dhe rregullorja e punës e Rektoratit propozohet nga Rektori, përkatësisht në Këshillin e Administrimit dhe në Senatin Akademik.
 4. Zyra e rregjistrimit kryen rregjistrimin fillestar të gjithë studenteve në Universitet, mban rekordet akademike dhe kryen rregjistrimin e studenteve për çdo semestër. Zyra e rregjistrimit drejtohet nga drejtori i zyrës së rregjistrimit.
 5. Zyra e kerkimit shkencor koordinon aktivitetin e gjithë Universitetit për aplikime për grante, marrëdhënie kërkimore-shkencore me universitete të tjera, kryen seminare kualifikimi me stafin akademik për përgatitjen e granteve. Zyra e kerkimit shkencor drejtohet nga Drejtori i kësaj zyre.
 6. Zyra akademike koordinon gjithë veprimtarinë akademike të Universitetit: Detyrat specifike të saj janë:
 - a. Krijon dhe monitoron gjithë komisionet e pranimeve të studenteve
 - b. Organizon gjithë procedurat e apelit për anën akademike
 - c. Monitoron dhe mban në nivel bashkohor katalogun e studentit
 7. Zyra e asistencës juridike: caktohet një prej pedagogëve të fakultetit ose një jurist i cili miratohet nga Senati, me propozim të Rektorit.
 8. Zyra e studenteve koordinon gjithë aktivitetet kulturore-shkencore të studenteve, merr ankesat e tyre për personelin akademik, organizon shoqatat studentore dhe monitoron procesin e zgjedhjeve të këtyre shoqatave.
 9. Zyra e burimeve njerezore mbulon gjithë problematikat dhe procedurat e burimeve njerezore.
 10. Zyra e marrëdhënieve me publikun koordinon gjithë marrëdhëniet e Universitetit me publikun dhe mediat.
 11. Dega ekonomike merret me gjithë aktivitetin ekonomiko-financiar të institucionit.

Fakultetet

1. Fakultetet si njesi kryesore perbehen nga njesite me emërtimet përkatëse, të cilat përcaktohen në rregulloren e Universitetit që miratohet në zbatim të këtij statuti. Fusha specifike e secilës njesi bazë përcaktohet në rregulloren e fakultetit.
2. Organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese në fakultet janë: këshilli i fakultetit, dekani, zëvendësdekanët dhe këshilli i profesorëve.
3. Këshilli i fakultetit, përveç kompetencave, që parashikohen në nenin 18, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ushtron edhe këto kompetenca:
 - a. miraton rregulloren e fakultetit;
 - b. propozon, për miratim në Senat, strukturën dhe numrin e punonjësve në fakultet;
 - c. miraton në parim marrëveshjet që synon të lidhë fakulteti i tyre me të tretë, përpara se të nënshkruhen nga dekani;
 - d. shpall projektet fituese, për t'u financuar nga fondet për kërkim shkencor nga buxheti i fakultetit, si dhe bursat për studime apo kërkime shkencore, që administrohen nga vetë fakulteti;
 - e. propozon listën e periodikëve shkencorë ku do të pajtohet fakulteti, si dhe titujt e librave që do të blihen për bibliotekën e fakultetit;
 - f. miraton mënyrën e përdorimit të dhurimeve që janë kryer në favor të një departamenti, duke marrë parasysh propozimin e departamentit përfitues;
 - g. ushtron edhe kompetenca të tjera që përcaktohen në rregulloren e Universitetit apo të Fakultetit, bazuar në specifikën e secilit Fakultet;
 - h. në ushtrimin e kompetencave të tij këshilli shprehet me vendime.
4. Dekani i fakultetit, veç pozitës juridike që përcaktohet për të, në paragrafin e dytë, të nenit 20, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", ushtron edhe këto kompetenca:
 - a. për çdo vendimmarrje të këshillit të fakultetit përgatit propozimin përkatës;
 - b. përgjigjet para këshillit të fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fakultet;
 - c. i komunikon zëvendës-rektorit akademik gjithë ecurinë e punës në fakultet dhe siguron zbatimin e vendimeve dhe urdherave të Rektorit ose zëvendës-rektorit akademik.
 - d. në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhra dhe udhëzime.

5. Zëvendësdekani, emërohet siç përcaktohet në pikën 5, të nenit 22, të ligjit nr.9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe duhet të plotësojë këto kritere:
 - a. të jetë lektor i një lënde dhe në marrëdhënie pune me afat të pacaktuar në atë fakultet;
 - b. nese nuk ka me tituj dhe grada, të ketë kryer, të paktën studimet pasuniversitare të nivelit "Master".

Zëvendësdekani ka pozitën juridike, siç përcaktohet në nenin 34, të Kodit të Procedurave Administrative. Fusha e kompetencës e secilit zëvendësdekan, aty ku janë emëruar më shumë se një, përcaktohet me urdhër të dekani.
6. Këshilli i profesorëve përbëhet nga të gjithë pedagogët që kanë të paktën titullin "Profesor i asociuar" në atë fakultet. Këshilli drejtohet nga dekani i fakultetit. Kompetencat e këtij këshilli janë:
 - a. percakton drejtimin akademik te fakultetit;
 - b. miraton propozimet e personave që kanë aplikuar për të mbrojtur doktoraturën;
 - c. miraton paraprakisht dosjet e personave që kanë aplikuar për titullin "Profesor i asociuar" dhe ia përcjell për procedurë të mëtejshme Rektoratit;
7. Secili fakultet miraton rregulloren e tij, bazuar në specifikën e fushës që mbulon.

Neni 16

Departamentet

1. Fusha e kërkimit shkencor, disiplinat mësimore dhe struktura organizative e secilit departament përcaktohen në rregulloren e fakultetit.
2. Pozita juridike e përgjegjësit të departamentit, marrëdhëniet e tij me pedagogët e departamentit, me organet e tjera në fakultet, si dhe me të tretët, përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

KREU IV: ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 17

Pranimet për studimet universitare

1. Në Universitetin e Vlores studimet ndiqen në këto sisteme:
 - a) studime me kohë të plotë;
 - b) studime me kohë të pjeshme;
2. Programet e studimeve propozohen nga Departamentet e Fakulteteve dhe Këshilli i Fakultetit dhe i paraqiten për miratim Senatit Akademik.
3. Universiteti i Vlores shpall publikisht programet e studimeve që ofron, para fillimit të aplikimeve për pranime në të.

Neni 18

Ciklet dhe titujt e studimeve universitare

Programet e studimeve në Universitetin e Vlores organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme:

1. cikli i parë,
2. cikli i dytë dhe
3. cikli i tretë.

1. Studimet e ciklit të parë:

Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të gjerë profesionesh e specialitetesh;

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë:

2.1 Programet e studimeve të ciklit të dytë japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda një specialiteti, realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

2.2 Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, si dhe plotësojnë standardet akademike të kriterëve të pranimit.

2.3 Kriteret e pranimit për studimet e ciklit të dytë përcaktohen në Rregulloret e Fakulteteve.

Programet e integruara:

2.1. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë:

Universiteti i Vlores në fusha të veçanta ofron programe të integruara të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë së bashku të cilat realizohen me jo më pak se 300 kredite dhe zgjatja normale e tyre

është jo më pak se pesë vite.

Kriteret e pranimit për kandidatët që dëshirojnë të ndjekin këto programe përcaktohen në Rregulloren e Fakultetit që ofron këto programe.

2.2. Programet e studimeve "Master i Nivelit të Parë":

Programet e studimeve "Master i Nivelit të Parë" u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë të nivelit të parë, arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

2.3 Programet e studimeve "Master i Nivelit të Dytë" (MND):

Programet e studimeve "Master i Nivelit të Dytë" u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë të nivelit të dytë, arsimim dhe trajnim të një niveli më të lartë shkencor ose profesional, realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është minimumi një vit;

Kriteret për pranim për MND përcaktohen në Rregulloret e Fakulteteve.

3. Studimet e ciklit të tretë:

3.1. Programet e studimeve të doktoratës:

Programet e studimeve të doktoratës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarura, zgjasin të paktën 3 vite dhe përfshijnë edhe 60 kredite për studime të organizuara;

3.2 Organizimi dhe funksionimi i programeve të studimeve të doktoratës, përcaktohet me rregullore të veçantë të Universitetit të Vlores.

Neni 19

Pranimi në ciklin e parë të studimeve

1. Çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në Universitetin e Vlores.
2. Ciklin e parë të studimeve në Universitetin e Vlores mund ta ndjekin edhe studentë të huaj kundrejt pagimit të tarifës së caktuar.
3. Universiteti i Vlores ka të drejtë të përcaktojë kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kritere bëhen publikisht të njohura nga Universiteti Ismail Qemali i Vlores të paktën një vit para fillimit të pranimeve të radhës në institucion, së bashku me informacionin e nevojshëm mbi Fakultetin përkatës dhe programet që ofron.

Neni 20

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në Universitetin e Vlores zhvillohen me bazë vitin

- akademik i cili organizohet në tre semestra: Simestri i Vjeshtes, Simestri i Dimrit, Simestri i Veres.
2. Vitit akademik fillon te henen e pare te muajit tetor te cdo viti kalendarik dhe konsiston nga Simestri I, Simestri II, Simestri III.
 3. Organizimi i vitit akademik, datat fillimit te simestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga Rektori ne fillim te vitit akademik.
 4. Kriteret e pranimit për standardet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë të studimeve përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

Neni 21

Transferimet

1. Universiteti i Vlores lejon mundësi për transferime të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë.

2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon Fakultetit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e tij.

Neni 22

Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve

1. Universiteti i Vlores mund të bëjë ekuivalentim të pjesëve ose programesh të plota studimi ose diploma të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja.

2. Procedurat dhe kërkesat për ekuivalentim përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

Neni 23

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik me tituj i Universiteti Ismail Qemali i Vlores ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik.

Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti edhe kurse specializimi deri tremujore jashtë institucionit.

2. Midis të interesuarit dhe Rektorit të Universiteti Ismail Qemali i Vlores nënshkruhet një kontratë e posaçme, elementet e së cilës vendosen me një akt nënligjor të Rektorit.

Neni 24

Vleresimi: Ne Universitetin e Vlores notat qe perdoren per vleresim jane: 1, ..., 10

Mesatarja: Mesatarja e studentit llogaritet si mesatare per kredit.

Titujt e Nderit: Tre nivelet e titujve të nderit nga Universiteti:

- cum laude,
- magna cum laude,
- summa cum laude,

mund të lëshohen sëbashku me diplomën universitare të fituar nga studentit, në bazë të mesatares së përgjithshme të notave si më poshtë:

- 8.00-8.89, cum laude;
- 8.90-9.39, magna cum laude; and
- 9.40-10.00, summa cum laude.

Nje student me mesatare 10 dekorohet nga Senati me "**Medalje te arte**".

Lëshimi i një diplome me tituj nderi nga Universiteti do të bazohet veëtm në kreditet e Universitetit të Vlorës dhe studentit duhet të fitojë të paktën 62 kredite në Universitetin e Vlorës në mënyrë që të jetë i zgjedhshëm për të tillë tituj nderi.

Në Universitetin e Vlores dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni te pergjithshme per te gjithë fakultetet në shkallë Universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqesuesve të Senatit, te profesoratit, administratës e studentëve.

Neni 25

Detyrimet e të Drejtat e Studentëve

Detyrimet

Nje person fiton statusin e studentit me regjistrimin në Universitetin e Vlores dhe e humbet me marrjen e diplomës ose çertifikatës përkatëse si edhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij.

Studentët janë të detyruar:

- a. Të zbatojnë rregullat e hartuara ne statut dhe rregullore;
- b. Te kete tregues cilesore dhe sasiore te ecurise akademike sipas kriterëve te percaktuara ne rregullore;
- c. Te ndjekin kurset e plota te leksioneve, seminareve, laboratoreve, praktikave mesimore, etj.
- d. Tu kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin

- pjesë në të gjitha veprimtaritë akademike;
- e. Të paguajnë tarifën e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofrojnë institucionet;
 - f. Të respektojnë kodin e etikës, të përcaktuar në statutet ose rregulloret e institucioneve respektive të arsimit të lartë;
 - g. Të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë.

Universiteti i Vlores nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.

Perjashtimet:

Rastet e perjashtimit të studentit janë kur studentit

- 1) Kur nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën b) si më sipër.
- 2) ose thyhen rregulloret e Universitetit

Të drejtat:

1) Të përfaqësohen në Këshillat e Fakulteteve, në Këshillin e Administrimit dhe në Senatin Akademik;

2) Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave si dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga Universiteti;

3) të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit.

4) Të ndjekin një degë të dytë studimesh kur plotësojnë kushtet akademike.

5) Të rregjistrohen për çdo lëndë që ofrohet në Universitet;

6) Të përdorin mjedise në bibliotekë, sallat kompjuterash dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;

7) Të organizohen në shoqata studentore jopolitike duke ju përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse;

KREU V: STRUKTURA , ORGANIKA DHE PUNESIMI

Neni 26

Struktura dhe Organika

Struktura dhe organika e personelit te Universiteti Ismail Qemali i Vlores percaktohet me akte te vecanta dhe ne perputhje me kerkesat e ketij statuti.

Neni 27

Personeli i Universitetit te Vlores perbehet nga:

Personeli akademik. Pjese e ketij personeli jane:

- Profesoret
- Docentet
- Lektoret

Personeli ndihmes mesimor shkencor.

Pjese e personelit ndihmes mesimor shkencor jane:

- Asistentet mesimore.
- Asistentet kerkimore

Personeli akademik i ftuar

Thirrret per nevoja te universitetit dhe duhet te kete titullin

- Profesor
- Docent
- Lektor

Personeli administrativ.

Pjese e personelit administrativ jane te gjithë punonjesit te cilet jane pjese e administrates dhe kryejne detyra qe sherbejne ne realizimin e misionit te arsimit te larte prane Universitetit te Vlores.

Neni 28

Punësimi i personelit me kohë të plotë

Punësimi ne Universitetin e Vlores behet ne mbeshtetje te legjislacionit te punes ne Republiken e Shqiperise, te ligjit nr 9741 dt 21.05.2007 "Per aresimin e larte ne Republiken e Shqiperise"dhe te ketij statuti .

Ky punesim realizohet nepermjet procedures se konkurimit te hapur duke garantuar nje proces transparent, te paanshem dhe objektiv.

Te drejtat dhe detyrat e personelit te Universitetit percaktohen ne rregulloret e njesive perkatese.

Neni 29

Kerkesat per Punësim

Personat kandidate per punesim te te trija niveleve, duhet te plotesojne keto kerkesa te pergjithshme:

- te zoterojne aftesite e nevojshme profesionale per vendin e punes per te cilin konkurojne
- te kene aftesine e punes ne grup dhe te komunikimit profesional me koleget dhe studentet
- te mos jene denuar me vendim te formes se prere te Gjykates per kryerjen e nje krimi
- te mos jete marre prej tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
- Te mos kene vepruar ose propoganduar ne veprim te prishjes se imazhit te universitetit

Kerkesat e vecanta vendosen ne njoftimin e konkurimit per vendin e lire te punes mbeshtetur ne pozicionin dhe pershkrimin e punes. Keto kerkesa percaktohen nga njesite perkatese qe kerkojne para Rektorit plotesimin e vendit vakant.

Neni 30

Norma mesimore dhe mbingarkesa

Norma mesimore per personelin akademik percaktohet me Udhëzim të Ministrat të Arsimit dhe të Shkencës.

Personelit akademik i njihet e drejta e pageses së oreve te realizuara mbi normen, sipas akteve ligjore e nenligjore ne fuqi.

Elemente te normes se pedagogut jane mesimdhënia, kerkimi shkencor, dhe veprimtaria ne mbeshtetje te institucionit.

Neni 31

Procedura e Konkurimit

Procedura e konkurimit fillon me publikimin e vendit te lire te punes.

Njoftimi per konkurim duhet te behet me miratimin e Rektorit dhe ky njoftim behet publik ne faqen e internetit dhe ne stendat e njoftimeve ne ambientet e Universitetit.

Njoftimi duhet te permbaje: pozicionin, pershkrimin e vendit te punes, kerkesat e pergjithshme dhe te vecanta, listen e dokumenteve qe duhet te paraqesin kandidatet, afatin brenda te cilit do te kryhen aplikimet per vendin vakant, vendin e dorezimit te dokumentacionit dhe menyren e dorezimit te tij (personalisht, me poste apo elektronike)

Pas paraqitjes se dokumentacionit nga aplikantet, per vendin vakant dhe dokumentimit te ketij dokumentacioni nga struktura perkatese e rektoratit ngrihet komisioni i vleresimit i cili i paraqet Rektorit rezultatet e konkurimit dhe i ben ato publike.

Neni 32

Komisioni i vleresimit te marrjes ne pune

Komisioni i vleresimit te kandidaturave perbehet nga

- tre anetare te departamentit perkates
- shefi i departamentit
- nje anetar nga nje departament tjetër

Komisioni zgjidhet me votim nga departamenti perkates. Shefi i departamentit eshte kryetar i komisionit.

Ky komision mbi bazen e dosjeve perkatese dhe intervistes ben vleresimin e gjithe kandidaturave te paraqitura. Mbi bazen e ketij vleresimi i behet propozimi dekanit perkates, i cili eshte i detyruar te jap opinionin e tij dhe te percjelle dosjet perkatese dhe klasifikimin tek zevendes-rektori akademik, brenda nje periudhe nje javore.

Rektori vendos perfundimisht mbi cdo kandidature qe paraqitet.

Neni 33

Koha e Provës

I punesuari ne Universitetin e Vlores i nenshtrohet nje periudhe prove (jo domosdoshmerisht) e cila nuk mund te jete me shume se sa 1 vit akademik. Ne mbarim te kesaj periudhe vendoset ne se marrdhenia e punes do te vazhdoje apo do te nderpritet. Ne rast te nderprerjes se marrdhenies se punes, te punesuarit duhet ti behen te ditura arsyet qe cojne ne marrjen e nje vendimi te tille.

Neni 34

Kontrata e Punës

Kontratat e punes, per personelin e Universitetit e Vlores nenshkruhen nga Rektori.

Rektori per disa kategori te caktuara punesh mund tia delegoje kete te drejte nje personi tjetër te autorizuar prej tij me akt perkates.

Kontrata e punes duhet te permbaje:

- identitetin e paleve
- vendin e punes
- pershkrimin e punes qe do te kryeje individi
- daten e fillimit
- kohezgjatjen e marredhenies se punes
- Kohezgjatjen e kohes se punes dhe te pushimit
- Pagen
- Normen mesimore (per personelin perkates)

Kontrata e punes nenshkruhet jo me vone se 30 dite nga dita e emerimit ne pune.

Neni 35

Personeli Akademik i Ftuar

Personeli akademik i ftuar perzgjidhet nga lista e personave qe propozohen nga departamentet perkatese duke mbajtur parasysh formimin akademik te tyre apo eksperiencen profesionale, ne nje fushe te caktuar, e cila i sherben nevojave konkrete te mesimdhenies ose kerkimit shkencor.

Kriteret per perzgjedhjen e ketij personeli percaktohen ne rregulloret e fakulteteve.

Neni 36

Personeli Akademik me Kontratë

Njesite kryesore me propozim te njesive baze, te cilat percaktojne nevojat e tyre per staf te jashtem, i kerkojne senatit akademik miratimin e personelit akademik me kontrate.

Senati Akademik duke u mbeshtetur ne propozimet e njesive kryesore dhe ne varesi te fondit financiar qe ka ne dispozicion, miraton cdo vit numrin e personelit akademik me kontrate.

Kjo kontrate do te nenshkruhet per nje pune te caktuar ose per nje kohe te caktuar. Rregulla me te hollesishme per menyren e konkurimit per personelin akademik me kontrate do te percaktohen ne Rregulloret e njesive kryesore.

Neni 37

Mbarimi i Marrëdhënies së Punës

Mbarimi i marredhenies se punes behet kur:

- Kur japin doreheqjen
- Kur mbaron afati i parashikuar ne kontraten e punes
- Kur behen te paafte per kryerjen e detyrave per shkaqe fizike dhe mendore;

- Kur denohen me vendim te formes se prere te Gjykates me heqje lirie;
- Kur konkludohet paaftesi per kryerjen e detyrave apo papershtatshmeri me vendin e punes (ne rastin e ndryshimit te kerkesave per vendin e punes apo ndryshim ose mbyllje te departamenteve dhe njesive te tjera)
- Kur nuk respektohet institucioni, thyhet etika profesionale, prishet imazhi i institucionit, nuk respektohet hierarkia universitare;
- Kur merret masa disiplinore e largimit nga puna.

Neni 38

Masat Disiplinore

Llojet e masave disiplinore jane:

- Terheqje vemendje
- Verejtje me shkrim
- Verejtje me paralajmerim
- Pezullim nga detyra
- Largim nga puna

Masat disiplinore jepen nga Rektori me propozim te shefit te departamentit, dekanit, zevendes-rektorit akademik.

Rastet per te cilat merret masa disiplinore percaktohen ne rregulloren e Universitetit.

Neni 39

Konflikti i Interesave

Punonjesit e Universitetit duhet te evitojne situatë qe krijojne konflikte midis Universitetit dhe interesave te tyre, po ashtu dhe institucioneve te tjera.

Neni 40

Kerkimi shkencor: Eshte detyre e Universiteti Ismail Qemali te Vlores dhe gjithë administrates se Universitetit te nxise kerkimim-shkencor. Kerkimi shkencor do te jete nje komponent i rendesishem i vleresimit vjetor per gjithë stafin akademik.

Miratuar me Vendim të Senatit të Universitetit Ismail Qemali te Vlores, marrë në mbledhjen e tij të datës: 12.09.2008.

KRYETARI I SENATIT
Prof. Dr. Tanush Shaska
(Rektor i Universitetit Ismail Qemali te Vlores)